1124
24.10.2024

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr 4954/1 Prot Elbasan më 23 /10/2024

VENDIM

Nr 107 datë 23 /10/2024.

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin SHTATOR 2024

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë" , V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesëmbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", si dhe bazuar në kriteret e VKB nr 11 datë 23.02.2024 "Mbi miratimin e kritereve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë"

VENDOSI

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i të ardhurave të bashkisë për muajin SHTATOR 2024, 81 familje me fond 209.660 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Dr Përgj Kujdesit Social D.Rroseni
Drejtori Juridik A.Hoxha
Drejtori Finance-Buxhet A. Merkja

Sekretar i Këshillit Bashkiak
Elvi Çuni

Kryetari i Këshillit Bashkiak
Lutfi Lala

Miratuar datë _____
Pro _____
Kundër _____
Abstenim _____

4954/2.
29.10.2024.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

Nr. 1184/1 **Prot** **Elbasan, më** 25.10.**2024**

Lënda: Konfirmim akti.

KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.107, datë 23.10.2024 "Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i bashkisë për muajin Shtator 2024", konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI
ALTMYSLIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

1485
24.10.2024

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr4955/1 Prot Elbasan më 23 /10/ 2024

VENDIM
Nr. 108 datë 23 /10/2024

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin SHTATOR 2024

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", nenin 21 të ligjit nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë" , V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesëmbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", si dhe bazuar në kriteret e VKB nr. 12 datë 23.02.2024 "Mbi miratimin e kritereve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike"

V E N D O S I

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e kushtëzuara per muajin **SHTATOR 2024** gjithsej 208 familje me një fond prej 920.349 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Drejtori Kujdesit Social D.Rroseni
Drejtori Juridik A.Hoxha
Drejtori Finance-Buxhet A. Merkja

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Elvi Çuni

Kryetari i Këshillit Bashkiak
Lutfi Lala

Miratuar datë _____
Pro _____
Kundër _____
Abstenim _____

Adresa: *Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web:www.elbasani.gov.al*

4955/2.
29.10.2024

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

Nr. 1185/1 **Prot** **Elbasan, më** 29.10.**2024**

Lënda: Konfirmim akti.

KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.108, datë 23.10.2024 "Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Shtator 2024", konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË-PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

PREFEKTI

Ali MYSLIU

1186

24.10.2024

REPUBLIKA SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr. 9059/3 Prot

Datë 23.10.2024

VENDIM

Nr. 109, datë 23.10.2024

"PËR DHËNIEN E MANDATIT TË ANËTARIT TË KËSHILLIT BASHKIAK Z. YMER BALLIU"

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 49 pika 1, neni 50, Këshilli i Bashkisë Tiranë, mbështetur në raportin e Komisionit të Vërtetimit të Mandateve, në mbledhjen e Këshilli Bashkiak:

V E N D O S I:

1. T'i japë mandatin e anëtarit të Këshillit Bashkiak Elbasan kandidatit në listën shumemërore të Partisë së Lirisë Z. Ymer Isuf Balliu.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Konc. L.Guri

SEKRETAR I
KËSHILLIT BASHKIAK
ELVI ÇUNI

KRYETAR I
KËSHILLIT BASHKIAK
LUTFI LALA

4059/4
29.10.2024

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI JURIDIK

Nr. 1186/1 **Prot.** **Elbasan më** 28.10.2024

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", pas verifikimit të ligjshmërisë së aktit tuaj nr.109 datë 23.10.2024 "Për dhënien e mandatit të anëtarit të Këshillit Bashkiak z. Ymer Balliu", konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI
Ali Mysliu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË-NVSH-PREFEKTI I QARKUT

Lgj "Brigada 17 Sulmuese", Rruga "Qemal Stafa", Tel 054 252138, ëëë.prefekti.elbasan.gov.al , email: prefekti.elbasan@mb.gov.al

1187
24.10.2024

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4468/1 **Prot.** **Elbasan, më** 23.10.2024

Vendim
Nr 110 **Datë** 23 / 10 /2024
Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit midis Bashkisë dhe A.SH.K.

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës 23 / 10 /2024, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga administrata e Bashkisë në lidhje me marrëveshjen e bashkëpunimit midis Bashkisë dhe Agjensisë Shtetërore të Kadastrës, për proçesin e legalizimit të ndërtimeve pa leje, si dhe draftin e paraqitur, bazuar në ligjin 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore" nenet 8, 9, 10, 30 e 54 të tij, VKM 435 datë 26.06.2024

Vendosi

1- Të miratojë Marrëveshjen e Bashkëpunimit midis Bashkisë Elbasan dhe Agjensisë Shtetërore të Kadastrës, sipas tekstit të draftit bashkangjitur këtij vendimi.
2- Ngarkohen Kryetari dhe strukturat administrative të Bashkisë me zbatimin e këtij vendimi.
3- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Sek. Këshillit Bashkiak
Elvi Çuni

Kryetari
Lutfi Lala

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA ELBASAN

D.P.P. A. Suli
D.P.ZH.T. A. Muhametaj
D. Juridike A. Hoxha
D.P.SH.O.B.F. G. Dyrmyshi
Zv/Kryetare A. Bylykbashi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA ELBASAN
Nr.4223 Prot, datë 24.09.2024

AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS
Nr.1084 Prot, datë 10.09.2024

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

"Agjencia Shtetërore e Kadastrës" (ASHK), me seli në Tiranë, rruga "Dora d'Istria",person juridik publik, përfaqësuar nga drejtori i përgjithshëm, znj. Lorena Goxhobelli;
dhe
"Bashkia Elbasan" , me seli në ....., person juridik publik, përfaqësuar nga kryetari z.Gledian Llatja;

të dyja së bashku të referuara më poshtë si "*Palët*";
të ndërgjegjshëm për rëndësinë e trajtimit me prioritet të procesit të legalizimit të ndërtimeve pa leje, në përputhje me legjislacionin në fuqi për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë, si dhe të rritjes së efikasitetit të këtyre procedurave administrative;
të ndërgjegjshëm se përfshirja e bashkive në procese që lidhen me administrimin e territorit mundëson zbatimin më efikas të legjislacionit për planifikimin e territorit dhe është më pranë qytetarit;
palët bien dakord për nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje sipas kushteve dhe afateve si vijon:

Neni 1
Qëllimi

Kjo marrëveshje parashikon mënyrën e bashkëpunimit, ndërveprimit dhe koordinimit ndërmjet palëve, në kuadër të zbatimit të legjislacionit në fuqi për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë dhe të trajtimit me prioritet të procedurave administrative të papërfunduara, për legalizimin e ndërtimeve pa leje në zonat me prioritet zhvillimi urban dhe zonat informale të banimit.

Neni 2
Baza ligjore

Kjo marrëveshje bashkëpunimi bazohet në kuadrin ligjor në fuqi dhe konkretisht në:
- Kushtetutën e Shqipërisë;
- Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë;
- Ligjin nr. 111/2018, "Për kadastrën";
- Ligjin nr. 20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në RSH" dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij;
- Ligjin nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar;
- Ligjin nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore";
- Ligjin nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore";
- Ligjin nr. 9887, da[illegible]0.3.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.

Neni 3
Objekti

Objekti i kësaj marrëveshjeje është përcaktimi i rregullave të bashkëpunimit, ndërveprimit dhe koordinimit midis ASHK-së dhe bashkisë, në kuadër të proceseve të papërfunduara për legalizimin e ndërtimeve pa leje, brenda territorit të Bashkisë, në zonat me prioritet zhvillimi urban dhe zonat informale të banimit.

Neni 4
Parimet e bashkëpunimit

Zbatimi i bashkëpunimit, sipas parashikimeve të kësaj marrëveshjeje, realizohet në respektim të parimit të decentralizimit të pushtetit dhe autonomisë vendore, të ligjshmërisë, transparencës, efikasitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Neni 5
Mënyra e bashkëpunimit

Në kuadër dhe në zbatim të kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi, palët angazhohen të bashkëpunojnë, bashkëveprojnë dhe koordinohen, në lidhje me sa vijon:

- të shkëmbejnë në mënyrë reciproke informacion, lidhur me ecurinë e procesit të legalizimit në funksion të planifikimit dhe zhvillimit të territorit, në përputhje me legjislacionin e posaçëm për proceset tranzitore;
- të komunikojnë, bashkërendojnë dhe koordinojnë veprimtarinë administrative ndërmjet tyre, në funksion të realizimit të kësaj marrëveshjeje;
- të organizojnë e marrin pjesë në takime të përbashkëta, përcaktojnë planin e punës, si dhe grafikun e prioriteteve në funksion të trajtimit me prioritet të procesit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;
- të caktojnë burime njerëzore të nevojshme për administrimin efikas të procesit administrativ. Për këtë qëllim, ASHK-ja dhe bashkia vlerësojnë nevojën dhe mundësitë reale për realizimin të këtij bashkëpunimi, duke përdorur të gjithë mekanizmat ligjore, financiare dhe/ose në burime njerëzore në dispozicion për përmbylljen e procesit sipas afatit të përcaktuar në këtë marrëveshje. Bashkia, sipas rastit, mund të transferojë fond me terma dhe specifikime të veçanta, në përputhje me legjislacionin për menaxhimin financiar dhe kontrollin, në favor të ASHK-së, për të mbuluar shpenzimet e pagave të stafit që do të angazhohet për zbatimin e kësaj marrëveshjeje. Në çdo rast, nëse palët vendosin transferimin e fondit nga bashkia tek ASHK-ja, fondi përdoret nga ASHK-ja vetëm për qëllim të realizimit të kësaj marrëveshjeje dhe në përputhje me specifikimet përkatëse. Bashkia, sipas rastit mund të vendosë në dispozicion të ASHK-së, nëpërmjet transferimit të punonjësve të bashkisë pranë ASHK-së, në funksion të realizimit të qëllimeve të kësaj marrëveshjeje. Në këtë rast, për periudhën e kohëzgjatjes së marrëveshjes, stafi i nënshtrohet procedurave ligjore të punësimit, sipas Kodit të Punës dhe legjislacionit në fuqi për kadastrën;

- të informojnë ministrin e Shtetit për Pushtetin Vendor, në mënyrë periodike, në lidhje me ecurinë e zbatimit të marrëveshjes dhe të VKM-së për "Rregullimin e bashkëpunimit midis institucioneve qendrore dhe vendore, për përshpejtimin e procesit të legalizimit të ndërtimeve pa leje";
- të bashkëpunojnë për realizimin sa më efikas, transparent dhe profesional të procesit administrativ në çdo formë tjetër që vlerësohet e nevojshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 6
Angazhimet e palëve

1. **Agjencia Shtetërore e Kadastrës, në zbatim të kësaj** marrëveshjeje, **angazhohet të kryejë si vijon:**

a) të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për identifikimin dhe evidentimin e kërkesave të subjekteve për legalizimin e ndërtimeve pa leje në territorin e zonave me prioritet zhvillimi urban dhe zonave informale të banimit;

b) të organizojë dhe të caktojë stafin e drejtorisë vendore të ASHK-së, në territorin e së cilës ndodhen nënzonat e propozuar nga bashkia, në funksion të realizimit të këtij procesi me volumin e kërkesave;

c) të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për shpenzimin e fondit të transferuar nga bashkia sipas përcaktimeve të kësaj marrëveshjeje. Të ndërmarrë të gjitha veprimet dhe procedurat e nevojshme, sipas legjislacionit në fuqi, në lidhje me punësimin e stafit të bashkisë për periudhën e kohëzgjatjes së marrëveshjes;

ç) të bashkëpunoj me stafin e bashkisë në kryerjen e procedurave të evidentimit në terren të objekteve në proces legalizimi në zonat me prioritet zhvillimi urban dhe zonave informale të banimit;

d) të kryejë veprimet e evidentimit në terren për objektet pa leje në zonat/bllokun gjeografik prioritar të propozuar nga bashkia, në prezencë të përfaqësuesve të caktuar të palëve. Përfaqësuesit e palëve nënshkruajnë procesverbalin (formular informativ) të miratuar nga drejtori i përgjithshëm i ASHK-së me urdhër të brendshëm;

e) të trajtojë me prioritet, në përputhje me legjislacionin në fuqi, kërkesat e subjekteve për legalizimin e ndërtimeve pa leje në zonat me prioritet zhvillimi urban dhe zonave informale të banimit;

f) të informojë bashkinë, pa vonesë, nëpërmjet përfaqësuesit të caktuar si person kontakti, për problematikat e hasura gjatë procedurës administrative, duke propozuar zgjidhje në funksion të ecurisë së procesit.

2. **Bashkia, në zbatim të kësaj marrëveshjeje, angazhohet të kryejë si vijon:**

a) të identifikojë dhe hartojë një listë të subjekteve për legalizimin e ndërtimeve pa leje në zonat me prioritet zhvillimi urban dhe zonave informale, kryesisht me funksion banimi, të ndara sipas nënzonave. Për këtë qëllim, bashkia harton listën me nënzonat brenda territorit dhe ia dërgon atë ASHK-së;

b) të përcjell te ASHK-ja nëpërmjet përfaqësuesit të caktuar si person kontakti, informacionin e grumbulluar dhe konsoliduar mbi evidentimin e subjekteve dhe ndërtimeve pa leje të zonës/bllokut përkatës, për procesim të mëtejshëm sipas legjislacionit në fuqi;

c) të vlerësojë krijimin e njësisë përgjegjëse dhe të caktojë stafin që do të përfshihet në administrimin e procesit sipas parashikimeve të kësaj marrëveshjeje;

ç) të identifikoj stafin e specializuar që do të vihet në dispozicion të ushtrojë detyrat pranë ASHK-së gjatë kohëzgjatjes së marrëveshjes, si dhe të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme sipas legjislacionit në fuqi, për propozimin dhe vënien në dispozicion për efekt të realizimit të parashikimeve të kësaj marrëveshjeje. Të identifikojë fondin që mund t'i transferohet nga ASHK-ja, për qëllim të realizimit të kësaj marrëveshjeje dhe të ndërmarrë të gjitha veprimet e

nevojshme, sipas legjislacionit në fuqi për transferimin e fondit sipas parashikimeve të kësaj marrëveshjeje;

d) të ofrojë ndihmë dhe informacion nëpërmjet stafit të bashkisë për subjektet mbi statusin e aplikimit dhe fazën apo ecurinë e procesit, në bllokun gjeografik prioritar të identifikuar nga bashkia;

e) të informojnë dhe sensibilizojnë subjektet në nënzona për procedurat e evidentimit në terren të ndërtimeve pa leje që do të kryhet nga ASHK-ja, si dhe të asistojë stafin e ASHK-së gjatë kryerjes së procedurave të evidentimit në terren të ndërtime pa leje;

f) të marrë pjesë në veprimet e evidentimit në terren për objektet pa leje në zonat/bllokun gjeografik prioritar të propozuar nga bashkia, në prezencë të përfaqësuesve të caktuar të palëve. Përfaqësuesit e palëve nënshkruajnë procesverbalin (formular informativ) të miratuar nga drejtori i përgjithshëm i ASHK-së me urdhër të brendshëm;

g) të informojë ASHK-në, në lidhje me projektet/studimet e bashkisë, të miratuara në zbatim të legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

Neni 7
Komunikimi midis palëve

Rakordimi i veprimeve administrative dhe shkëmbimi i informacionit shkëmbimit të informacionit kryhet vetëm në formë shkresore dhe/ose elektronike.

Neni 8
Përdorimi i informacionit

Informacioni i mbledhur, përpiluar, procesuar dhe shkëmbyer midis palëve, sipas legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, përdoret vetëm për realizimin e bashkëpunimit sipas parashikimeve të kësaj marrëveshjeje.

Neni 9
Shkëmbimi i informacionit në mënyrë periodike

1. Përfaqësuesit e palëve mbajnë kontakt të vazhdueshëm, në funksion të zbatimit efektiv të kësaj marrëveshjeje. Përfaqësuesit zhvillojnë çdo muaj takime, në lidhje me ecurinë e procesit administrativ.
2. Në fund të çdo muaji, çdo përfaqësues harton informacion të detajuar mbi ecurinë e procesit dhe ia dërgon përkatësisht drejtorit të ASHK-së dhe kryetarit të bashkisë. Drejtori i ASHK-së dhe kryetari i bashkisë i dërgojnë, çdo muaj, ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor informacionin e detajuar mbi ecurinë.

Neni 10
Afati i marrëveshjes

1. Kjo marrëveshje bashkëpunimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimin e saj nga palët dhe është e vlefshme 1 (një) vit nga momenti i nënshkrimit të saj.
2. Çdo ndryshim i kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi bëhet në formë shkresore dhe me miratimin e të dyja palëve.
3. Secila palë, nëse për arsye objektive është në pamundësi objektive për të përmbushur angazhimet sipas kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi, mund ta zgjidhë atë në mënyrë të njëanshme në çdo kohë, duke njoftuar me shkrim palën tjetër të paktën 30 (tridhjetë) ditë përpara.

4. Secila palë mund ta zgjidhë marrëveshjen në çdo kohë, nëse pala nuk respekton detyrimet e përcaktuara dhe nuk merr masa për rregullimin e pasojave, brenda 10 ditëve nga njoftimi me shkrim i palës tjetër.

Kjo marrëveshje hartohet dhe nënshkruhet në 3 (tre) kopje origjinale.

BASHKIA ELBASAN

KRYETAR
Gledian LLATJA

AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Lorena GOXHOBELLI

4468/2.
24.10.2024

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI I ZHVILLIMIT URBAN

Nr. 1187/2 prot. Elbasan, më 25.10.2024

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të Ligjit Nr.107/2016 dt.27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", i ndryshuar, pasi u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj Nr.110 datë 23.10.2024 "Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit midis bashkisë dhe A.SH.K.", konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

Ali MYSLIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKRETARIA
1182
24.10.2024

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4495/2 **prot.** **Elbasan, më** 24 . 10 **.2024**

VENDIM

Nr. 111 **Datë** 23 . 10 **.2024**

"Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB nr. 116, datë 30.11.2023 "Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Elbasan, për vitin 2024"

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës 23 . 10 .2024, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Administrata dhe Kryetari i Bashkisë Elbasan *"Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB nr. 116, datë 30.11.2023 "Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Elbasan, për vitin 2024"*, bazuar në:

- Ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar;
- Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar;
- Ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 "Për proçedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- Ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008 "Për taksat kombëtare", i ndryshuar;
- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 144, datë 13.02.2020 Për disa ndryshime në vendimin nr. 132, datë 7.3.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesë", e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kritereve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës", i ndryshuar,
- Ligjin nr. 79/2017 "Për sportin", neni 33 "Shfrytëzimi i objekteve sportive".

VENDOSI:

Në vazhdimësi të korrenspodencës me Drejtorinë e Përgjithme të Taksës së Pasurisë, sipas shkresës nr. 417 prot., datë 23.07.2024 dhe shkresës nr. 28/2 prot., datë 09.08.2024 mbi parashikimet ligjore dhe nënligjore mbi taksën e pasurisë së paluajtshme "ndërtesë" si dhe relacionit nr.4495 prot., datë 27.09.2024bëhen ndryshimet në përcaktimet dhe formulimet e neneve si mëposhtë:

Neni 3 "Taksa mbi pasuritë e paluajtshme"
Ishte:

Taksa mbi pasurinë e paluajtshme përbëhet nga:

1. Taksa mbi ndërtesat.
2. Taksa mbi tokën bujqësore.
3. Taksa mbi truallin (jo hapësirë publike).

Bëhet:

1. Taksës mbi pasurinë e paluajtshme i nënshtrohen të gjithë personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, pronarë apo përdorues të pasurive të mësipërme, në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre pasurive. Bëjnë përjashtim rastet kur në ligj parashikohet ndryshe. Detyrimin për taksën mbi pasurinë e paluajtshme e ka, sipas rastit, pronari ose bashkëpronari, sipas pjesës që zotëron, apo përdoruesi i pasurisë së paluajtshme, për pasuritë që nuk janë të pajisura me dokumente pronësie.

2. Taksa mbi pasurinë e paluajtshme përbëhet nga:
   - Taksa mbi ndërtesat.
   - Taksa mbi tokën bujqësore.
   - Taksa mbi truallin (jo hapësirë publike).

Neni 4, pika 5
Ishte:
Niveli tregues i taksës, janë nivelet e taksave të parashikuara sipas këtij vendimi.

Bëhet:
Niveli tregues i taksës, janë nivelet e taksave të parashikuara sipas Ligjit 9632/2006, si dhe sipas këtij vendimi.

Ishte:
Neni 4, pika 5
Çmim vlerësues, njësia matëse e vlerës për metër katror të sipërfaqes së ndërtimit të pasurisë së paluajtshme. Ky çmim mund të jetë çmimi i tregut ose çmimi i vlerësuar.
Bëhet:
Çmim vlerësues, njësia matëse e vlerës për metër katror të sipërfaqes së ndërtimit të pasurisë së paluajtshme. Ky çmim mund të jetë çmimi i tregut ose çmimi i vlerësuar sipas VKM 132 i ndryshuar.

Neni 5
Taksa mbi pasurinë e paluajtshme "ndërtesë"
Ishte:

Vlera e taksës së ndërtesës do të përllogaritet në përputhje me parashikimet dhe përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 132, datë 07.03.2018, "Për metodologjinë dhe përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesë", e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit, të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kritereve e rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës", të ndryshuar, anekset 1 dhe 2 si dhe çdo akti tjetër që normon këtë proces.

Bëhet:

1. Përcaktimi i vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesë"/njësi pronësore bazohet mbi prioritetet e vlerësimit duke ndjekur një radhë të caktuar.
2. Baza e vlerësimit mbështetet tek vetdeklarimi, ku çdo taksapagues duhet të vetdeklarojë të dhënat mbi pasurinë e tij të paluajtshme "ndërtesë"/njësi pronësore që ka në pronësi apo përdorim. Vetëdeklarimi bëhet pranë zyrave të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, për të marrë dhe për të përpunuar informacionin e vetëdeklarimit të taksapaguesit, për qëllim të zbatimit të legjislacionit përkatës të taksës mbi pasurinë e paluajtshme.Në rast se vlera e vetëdeklaruar nga taksapaguesi rezulton e ndryshme nga vlera e llogaritur me çmim e vlerësuar, të përcaktuar me këtë metodologji, si vlerë e bazës së taksës do të merret vlera më e lartë.
3. Për taksën e pasurisë së paluajtshme "ndërtesë", për të cilat nuk disponohet vlera e ndërtesës, do të përdoret vlera referuese për sipërfaqje të banesës, 100 (njëqind) metër katror sipërfaqje për njësi pronësore për ndërtesat për banim dhe 70 (shtatëdhjetë) metër katror sipërfaqje për njësi pronësore, për ndërtesat për banim të privatizuara me ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992, "Për privatizimin e banesave shtetërore", të ndryshuar ose të ndërtuara para vitit 1991 në Njësitë Administrative. Për ndërtesat e tjera, të cilat nuk shërbejnë për qëllime banimi, njësitë e vetëqeverisjes vendore bëjnë verifikimin në terren, për të përcaktuar sipërfaqen dhe për të llogaritur bazën e taksës. Kur gjatë verifikimeve në terren konstatohen dëmtime të ndërtesave për shkaqe të fatkeqësive natyrore (tërmet/zjarr/përmbytje etj.), të cilat ndryshojnë vlerën e kësaj pasurie, njësia e vetëqeverisjes vendore, sipas rastit që i paraqitet, ngre një komision, i cili vlerëson dhe korrekton vlerën e ndërtesës. Vlerësimi bëhet sipas gjendjes fizike në të cilën paraqitet ndërtesa e dëmtuar.
4. Përsa i përket kategorisë së ndërtesave që përdoren, shfrytëzohen për veprimtari ekonomike nëse subjekti nuk ka realizuar deklarimin nëpërmjet dorëzimit të dokumentacionit të pronësisë vlerësimi realizohet sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 132, datë 07.03.2018 "Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesë", e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kritereve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës", i ndryshuar".

Neni 6 "Për ndërtesat të cilat shërbejnë për banim"

Ishte:

1. Shkalla e taksës për sipërfaqje ndërtesë banesë në qytet është 0.05% e çmimit mesatar referues *(Shembull: Vlera për m^2 = 1 m^2 x 0, 05 % x 50.300= **25.15** lekë).*
2. Të aplikohet ulja e taksës me 30% të çmimit mesatar referues për sipërfaqjet ndërtesë banesë në të gjitha Njësitë Administrative (çmimi nga 50,300 shkon në 35,210) *(Shembull: Vlera për m^2 = 1 m^2 x 0, 05 % x 35,210= **17.605** lekë).*

Bëhet:

Neni 6 "Shkalla e taksës mbi ndërtesat"

1. Shkalla e taksës mbi ndërtesat, e cila aplikohet si përqindje e bazës së taksës, është si mëposhtë:

I) 0,05% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për banim;

II) 0,2% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike;

III) 30% e shkallës së taksës përkatëse për të gjithë sipërfaqen ndërtimore, për të cilën zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur ta përfundojë atë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

Shtohet:

Neni 6/ 1 "Për ndërtesat të cilat shërbejnë për banim"

2.Shkalla e taksës për sipërfaqje ndërtesë banesë në qytet është 0.05% e çmimit mesatar referues *(Shembull: Vlera për m^2 = 1 m^2 x 0, 05 % x 50.300[1]= **25.15** lekë).*

3.Të aplikohet ulja e taksës me 30% të çmimit mesatar referues për sipërfaqjet ndërtesë banesë në të gjitha Njësitë Administrative (çmimi nga 50,300 shkon në 35,210) *(Shembull: Vlera për m^2 = 1 m^2 x 0, 05 % x 35,210= **17.605** lekë).*

Neni 8 "Modalitete"

Ishte:

1. Taksa vendore mbi pasurinë e paluajtshme "ndërtesë" llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit.
2. Për taksën e pasurisë së paluajtshme "ndërtesë", për të cilat nuk disponohet vlera e ndërtesës, do të përdoret vlera referuese për sipërfaqje të banesës, 100 (njëqind) metër katror sipërfaqje për njësi pronësore për ndërtesat për banim dhe 70 (shtatëdhjetë) metër katror sipërfaqje për

[1] 50300 është çmimi për m^2 për ndërtesë banesë në qytet.

njësi pronësore, për ndërtesat për banim të privatizuara me ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992, "Për privatizimin e banesave shtetërore", të ndryshuar ose të ndërtuara para vitit 1991 në Njësitë Administrative.

3. Përsa i përket kategorisë së ndërtesave që përdoren, shfrytëzohen për veprimtari ekonomike nëse subjekti nuk ka realizuar deklarimin nëpërmjet dorëzimit të dokumentacionit të pronësisë vlerësimi realizohet sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 132, datë 07.03.2018 "Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesë", e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kritereve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës", i ndryshuar".
4. Për ndërtesat në pronësi të shoqërive të ndërtimit, të destinuara për shitje, por që janë ende të pa shitura, taksa do të vendoset sipas destinacionit të përdorimit të ambjentit të ndërtesës.

Bëhet:

1. Taksa vendore mbi pasurinë e paluajtshme "ndërtesë" llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit.
2. Për regjistrimin për herë të parë të ndërtesave/njësive pronësore ose nëndarjeve të saj në mungesë të dokumentacionit të vetdeklaruar nga subjektet do të realizohet verifikimi në terren. Vetëvlerësimi i ndërtesës/njësisë pronësore do të bëhet mbi sipërfaqen e verifikuar në terren.
3. Për ndërtesat në pronësi të shoqërive të ndërtimit, të destinuara për shitje, por që janë ende të pa shitura, taksa do të vendoset sipas destinacionit të përdorimit të ambjentit të ndërtesës.
4. Në rast se një pronë shtrihet në territorin e më shumë se një bashkie, pavarësisht nga vendbanimit i pronarit, secila njësi vendore e trajton pjesën e pronës, që ndodhet brenda territorit të vet, si pronë më vete dhe zbaton mbi të dispozitat e këtij ligji.
5. Taksapaguesi, në çdo kohë, kur gjykon se vlerësimi i pasurisë së tij të paluajtshme ndërtesë, objekt taksimi, është jo i saktë, ka të drejtë të kërkojë korrigjimin e detyrimit. Taksapaguesi, pas marrjes së njoftimit të detyrimit për taksën e pasurisë, kur nuk është dakord me këtë vlerësim, ka të drejtë të bëjë kërkesë për korrigjimin e vlerës pranë D.T.T.V duke paraqitur dokumentacionin justifikues. E drejta ose jo e korrigjimit të vlerës përfundim-tare të pasurisë së paluajtshme "ndërtesë" do të përcaktohet pas shqyrtimit të ankimimit nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, brenda 30 ditëve.
6. Nëse edhe pas marrjes së përgjigjes në lidhje me të drejtën e korrigjimit, taksapaguesi nuk bie dakord me qëndrimin e zyrës tatimore pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore, ai ka të drejtë që, bazuar në nenin 7, "Ankimimi", të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar, t'i drejtohet strukturës vendore të apelimit tatimor të ngritur për këtë qëllim pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore. Struktura vendore e apelimit tatimor jep qëndrimin e saj brenda afatit ligjor të parashikuar në legjislacionin tatimor.

Për përmirësimin e vkb- së nr. 116 datë 30.11.2023 , shfuqizimin i **Nenit 32/1** "Investimet publike të kryera nga Bashkia Elbasan përjashtohen nga detyrimi për pagimin e tarifave vendore".

Shtimin e pikës 1-3c në Aneksin nr. 6 (Tarifat e Transportit): Për parkimet e rezervuara për institucionet publike dhe Sh.A në të cilat ka aksione Bashkia, tarifa e parkimit do të jetë 15,000 lekë/ vit. Është e njëjtë dhe joprogresive.

Ishte:

1	**Tarifë Parkimi**				
1-1	Tarifë orare parkimi.		lekë /ora		50
1-2	Tarifë vjetore parkimi.				
1-2a	Taksi 4+1.		lekë /vit		5,000
1-2b	Taksi 8+1.		lekë /vit		5,000
1-2c	Autovetura familjare.		lekë /vit		1,500
1-2d	Automjet transport i përzier deri 3.5 ton.		lekë /vit		2,500
1-2e	Kamion transport malli 3.5 deri 8 ton.		lekë /vit		4,000
1-2f	Kamion transport malli 8 deri 14 ton.		lekë /vit		5,500
1-2g	Kamion transport malli mbi 14 ton.		lekë /vit		6,500
1-2h	Autobus.		lekë /vit		9,000
1-3	***Tarifë*** Parkim i rezervuar në rrugë dhe sheshe për subjektet e liçensuara.				
	Paketa/Abonim	Nr. Vend Parkimi (V.P)	ditë/vit	lekë/ditë	tarifa/lekë
1-3a	Kontrata 1 vit	Për 1, V.P.	365	200	73,000
		Të 2-tin, V.P.	365	250	91250
		Të 3-tin V.P.	365	300	109500
		Të 4-tin V.P.	365	350	127750
1-3 b	Tarifë rivendosje tabele parkim i rezervuar	lekë/ rivendosje			3,000
2	**Karroatreci**		lekë/ngarkesë		3,000
3	**Tarifë embleme për taksi**		lekë/mjet		500
4	**Leje qarkullimi në qytet për mjetet e rënda**				
4.1a	Leje ditore për mjetet me kapacitet 3.5 deri 8 ton për mjetet green		lekë/ditë		0

REPUBLIKA E SHQIPËRISË- BASHKIA ELBASAN

4.2a	Leje ditore për mjetet me kapacitet 3.5 deri 8 ton për mjetet Euro 5	lekë/ditë	100
4.3a	Leje ditore për mjetet me kapacitet 8 deri 14 ton për mjetet Euro 5	lekë/ditë	200
4.4a	Leje ditore për mjetet me kapacitet mbi 14 ton për mjetet Euro 5	lekë/ditë	300
4.1b	Leje 3 mujore për mjetet me kapacitet 3.5 deri 8 ton.	lekë/ 3 muaj	5,000
4.2b	Leje 3 mujore për mjetet me kapacitet 8 deri 14 ton.	lekë/ 3 muaj	6,500
4.3b	Leje 3 mujore për mjetet me kapacitet mbi 14 ton.	lekë/ 3 muaj	7,500
4.1c	Leje vjetore për mjetet me kapacitet 3.5 deri 8 ton.	lekë/ vjet	10,500
4.2c	Leje vjetore për mjetet me kapacitet 8 deri 14 ton.	lekë/ vit	15,500
4.3c	Leje vjetore për mjetet me kapacitet mbi 14 ton.	lekë/ vit	20,500
4.1d	Leje vjetore per mjetet me kapacitet deri ne 3.5 ton.	lekë/vit	5,500
5	Leje qyteti për karrocat.	lekë/vit	2,500

- Kontrata e parkimit të rezervuar të lidhet për një afat 1 (një) vit ushtrimor i cili përkon me vitin kalendarik (fiskal). Vetëm për vitin e parë periudha do të llogaritet nga data e regjistrimit pranë sektorit të transportit deri në 31 dhjetor, duke përllogaritur vlerën ditore të paketës së abonimit shumëzuar ditët e mbetura deri në fund të vitit ushtrimor.
- Për çdo kategori poshtë mjeteve Euro 5 do të ketë rritje progresive të dyfishtë, në raport me një kategori më lart.

Bëhet:

Aneksi nr. 6 (Tarifat e Transportit)

1	**Tarifë Parkimi**		
1-1	Tarifë orare parkimi.	lekë /ora	50
1-2	Tarifë vjetore parkimi.		
1-2a	Taksi 4+1.	lekë /vit	5,000
1-2b	Taksi 8+1.	lekë /vit	5,000
1-2c	Autovetura familjare.	lekë /vit	1,500
1-2d	Automjet transport i përzier deri 3.5 ton.	lekë /vit	2,500
1-2e	Kamion transport malli 3.5 deri 8 ton.	lekë /vit	4,000
1-2f	Kamion transport malli 8 deri 14 ton.	lekë /vit	5,500
1-2g	Kamion transport malli mbi 14 ton.	lekë /vit	6,500
1-2h	Autobus.	lekë /vit	9,000
1-3	***Tarifë*** Parkim i rezervuar në rrugë dhe sheshe për subjektet e liçensuara.		

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA ELBASAN

Paketa/Abonim		Nr. Vend Parkimi (V.P)	ditë/vit	lekë/ditë	tarifa/lekë
1-3a	Kontrata 1 vit	Për 1, V.P.	365	200	73,000
		Të 2-tin, V.P.	365	250	91250
		Të 3-tin V.P.	365	300	109500
		Të 4-tin V.P.	365	350	127750
1-3 b	Tarifë rivendosje tabele parkim i rezervuar	lekë/ rivendosje			3,000
1-3c	Tarifë për parkimet e rezeevuara për institucionet publike dhe Sh.A në të cilat ka aksione Bashkia.	Lekë/vit			15,000
2	**Karroatreci**		lekë/ngarkesë		3,000
3	**Tarifë embleme për taksi**		lekë/mjet		500
4	**Leje qarkullimi në qytet për mjetet e rënda**				
4.1a	Leje ditore për mjetet me kapacitet 3.5 deri 8 ton për mjetet green		lekë/ditë		0
4.2a	Leje ditore për mjetet me kapacitet 3.5 deri 8 ton për mjetet Euro 5		lekë/ditë		100
4.3a	Leje ditore për mjetet me kapacitet 8 deri 14 ton për mjetet Euro 5		lekë/ditë		200
4.4a	Leje ditore për mjetet me kapacitet mbi 14 ton për mjetet Euro 5		lekë/ditë		300
4.1b	Leje 3 mujore për mjetet me kapacitet 3.5 deri 8 ton.		lekë/ 3 muaj		5,000
4.2b	Leje 3 mujore për mjetet me kapacitet 8 deri 14 ton.		lekë/ 3 muaj		6,500
4.3b	Leje 3 mujore për mjetet me kapacitet mbi 14 ton.		lekë/ 3 muaj		7,500
4.1c	Leje vjetore për mjetet me kapacitet 3.5 deri 8 ton.		lekë/ vjet		10,500
4.2c	Leje vjetore për mjetet me kapacitet 8 deri 14 ton.		lekë/ vit		15,500
4.3c	Leje vjetore për mjetet me kapacitet mbi 14 ton.		lekë/ vit		20,500
4.1d	Leje vjetore per mjetet me kapacitet deri ne 3.5 ton.		lekë/vit		5,500
5	Leje qyteti për karrocat.		lekë/vit		2,500

- Kontrata e parkimit të rezervuar të lidhet për një afat 1 (një) vit ushtrimor i cili përkon me vitin kalendarik (fiskal). Vetëm për vitin e parë periudha do të llogaritet nga data e regjistrimit pranë sektorit të transportit deri në 31 dhjetor, duke përllogaritur vlerën ditore të paketës së abonimit shumëzuar ditët e mbetura deri në fund të vitit ushtrimor.
- Për çdo kategori poshtë mjeteve Euro 5 do të ketë rritje progresive të dyfishtë, në raport me një kategori më lart.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA ELBASAN

Bashkia Elbasan ka në pronësi objektin: Stadiumi "Elbasan Arena" me adresë: Lagjia "Emin Matraxhiu", Rruga "Kozma Naska". Ambjentet dhe fusha në stadiumin "Elbasan Arena", bazuar në kërkesat dhe përcaktimin nga ana e Federatës Shqiptare të Futbollit, mund të ofrohet dhe të vihet në dispozicion të klubeve që nuk kanë për zhvillimin e ndeshjeve zyrtare. Tarifat e propozuara mëposhtë parashikohet të mbulojnë kostot e mirëmbajtjes së fushës, ambjentet e shërbimit, dhomave të zhvjeshjes, kostove për ujë dhe energji etj. Tarifat e propozuara janë referuar ligjit nr. 79/2017 "Për sportin", neni 33 "Shfrytëzimi i objekteve sportive", gjithashtu edhe tarifave të miratuara nga FSHF-ja pë vënien në dispzicion të stadiumeve. Përsa mësipër, shtohet pika 3 e nenit 49 **Tarifa për Klubin Shumësportësh si mëposhtë:**

Ishte:
Klubi Shumësportësh, aplikon këto tarifa:

1. Për përdorim salle të pallatit të sportit:
   a. Ndeshje 10.000 lekë/ora
   b. Stërvitje 40.000 lekë/ora
   c. Bamirësi 0 lekë/ora
   d. Panaire, koncerte,takime elektoralesh etj. 100.000 lekë/ora

2. Për përdorimin e kompleksit sportiv "Shefqet Lamçja":
   a. Ndeshje 5000 lekë
   b. Stërvitje 3000 lekë

3. **Për përdorimin e stadiumit "Elbasan Arena":**
   a. Ndeshjet e Kampionatit Kombëtar/ndeshje pa ndriçim 300,000 lekë
Vota Kundër_____
Vota Abstenim_____
Zbardhur me datë ____/____ 2024

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI BASHKIAK

TABELA E AUTOMJETEVE DHE HARXHIMI

Nr	Targa e mjetit	Tipi I mjetit	Norma e konsumit	KARBURANTI
1	AB 648 PT	Volvo	11 Litra/100 km Ne muaj 200 Litra	Gazoil D 1
2	AB 589 RA	Nissan	14 Litra/100 km Ne muaj 300 litra	Gazoil D 1

Konceptoi:Denada Sulanjaku

Drejtori Pyjeve :Klajd Gripshi

Miratoi

Drejtori I Pergjithshem

Shpëtim Çullhaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
AGJENCIA E PYJEVE, BUJQËSISË DHE MJEDISIT

Nr 696/1 Prot

Elbasan më: 15 .10 .2024.

PROCES VERBAL

Mbështetur në Ligjin Nr.139/2015,"Për vetëqeverisjen vendore; në Ligjin Nr 10296,datë 08.07.2010'Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"për nevojat e përdorimit racional dhe të përditshëm të karburantit

Mbahet ky procesverbal në prani të komisionit të ngritur me urdhërin Nr 208, datë 15.10.2024 nr. 696 prot. datë 15.10.2024.

Anetarët e komisionit:

1. Arben Hakballa

2. Klajd Gripshi

3. Jakov Bodurri

Në bazë të verifikimit të fakteve dhe provave konkludohet si më poshtë :

1. Automjeti tip Volvo XC60 me targë AB 648 PT për 100 km të përshkruar harxhon 11 litra Gazoil.

2. Automjeti tip Nissan Pathfinder me targë AB 589 RA për 100 km të përshkruar harxhon 14 litra Gazoil.

Në përcaktimin e normativave u mbajtën parasysh normativat egzistuese, disa tregues të rëndësishëm sic jane viti i prodhimit , tipi e lloji i mjetit, amortizimi i tij, gjendja reale teknike e mjetit, rrugët që do të përshkohen, ndalesa në semafore, trafiku në qytet, natyra e punës si edhe nevojat e përdorimit të funksioneve shtesë etj.

Këto normativa do të zbatohen për periudhën **01.01.2024-31.03.2025.**

KOMISION

Arben Hakballa

Klajd Gripshi

Jakov Bodurri

DREJTOR I PERGJITHSHEM

Shpëtim Çullhaj

4950/2
6.11.2024.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

Nr. 1190/1 **Prot.** **Elbasan, më** 04.11.**2024**

Lënda: *Konfirmim Akti*

KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të Ligjit Nr.107/2016 dt.27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", të ndryshuar me ligjin nr. 36/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", pasi u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj Nr.114 datë 23.10.2024 "Për miratimin e normave dhe kritereve për disiplinimin e shpenzimeve për Automjete motorrike në administrim të APBM", konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj.

Normativat e konsumit të karburantit të miratuar të fillojnë efektet juridike datën e miratimit të aktit të sipërcituar nga këshilli bashkiak Elbasan.

P R E F E K T I

Ali MYSLIU

Lgj.Brigada "17 Sulmuese", Rruga "QemalStafa", Tel.054252138 www.prefektielbasan.gov.al, e-mail: prefekti.elbasan@mb.gov.al

D.Pronove Publike.

115/1
24.10.2024

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 49521 Prot. Elbasan, më: 24.10.2024.

V E N D I M

Nr. 115 Datë: 23.10.2024.

"Mbi miratimin në parim të fillimit të proçedurës për shpronësimin e pasurive pronë private për realizimin e projektit, me interes publik "Rikualifikim i Rrugës "Vasil Llapushi" Loti I në Z.K 8522-8523"", nga Bashkia Elbasan dhe burimin e financimit të këtij shpronësimi""".

Bazuar në ligjin Nr. 139/2015 *"Për Vetëqeverisjen Vendore"*, i ndryshuar, në ligjin nr. 8561 datë 22.12.1999 *"Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik"*, i ndryshuar, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ___.10.2024 pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Planifikim-Zhvillimit Urban dhe Shërbimeve Infrastrukturore:

V E N D O S I :

1. Miratimin në parim për fillimin e proçedurës së shpronësimit për pasuritë pronë private që preken nga realizimi projektit me interes publik *"Rikualifikim i Rrugës "Vasil Llapushi" Loti I në Z.K 8522-8523""*. (planimetri bashkëlidhur).
2. Miratimin e burimit të financimit për shpronësimin e pasurive të prekura nga projekti i lartpërmendur, i cili do të mbulohet nga buxheti i Bashkisë Elbasan për vitin 2024.
3. Për zbatimin e këtij vendimi dhe vazhdimësinë e proçedurës së mëtejshme ngarkohet Komisioni i Shpronësimit, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikim-Zhvillimit Urban dhe Shërbimeve Infrastrukturore
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN

KRYETARI

Lutfi Lala

SEKRETARI

Elvi Çuni

Konceptoi: G. Kerri	*A. Braneshi*
Drejtoria P.P.:	*A. Suli*
Drejtoria F.B.:	*A. Merkja*
Drejtoria P: E. Mihali	*M. Avllazagaj*
Drejtoria J. I:	*A. Hoxha*
Zv/Kryetar:	*A. Bylykbashi*

Miratuar me _____ vota

Vota Pro _____

Vota kundër _____

Vota Abstenim_____

Zbardhur më datë_____/_____/2024

4952/1.
30.10.2024.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI I ZHVILLIMIT URBAN

Nr. 1191/1 prot.

Elbasan, më 30.10.2024

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të Ligjit Nr.107/2016 dt.27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", i ndryshuar, pasi u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj Nr.115 datë 23.10.2024 "Për miratimin në parim të fillimit të procedurës për shpronësimin e pasurive pronë private, për realizimin e projektit me interes publik: "Rikualifikim i rrugës "Vasil L!apushi", loti I, në Z.K. 8522-8523", nga Bashkia Elbasan dhe burimin e financimit të këtij shpronësimi", konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

Ali MYSLIU

1182
24.10.2024

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 49531 Prot. Elbasan, më: 24.10.2024.

V E N D I M

Nr. 116 Datë: 23.10.2024.

"Mbi miratimin në parim të fillimit të proçedurës për shpronësimin e pasurive pronë private për realizimin e projektit, me interes publik "Ndërtim i rrugës "Bexhet Hyti" në Z.K 2654", nga Bashkia Elbasan dhe burimin e financimit të këtij shpronësimi"".

Bazuar në ligjin Nr. 139/2015 *"Për Vetëqeverisjen Vendore"*, i ndryshuar, në ligjin nr. 8561 datë 22.12.1999 *"Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik"*, i ndryshuar, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ___.10.2024 pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Planifikim-Zhvillimit Urban dhe Shërbimeve Infrastrukturore:

V E N D O S I :

1. Miratimin në parim për fillimin e proçedurës së shpronësimit për pasuritë pronë private që preken nga realizimi projektit me interes publik *"Ndërtim i rrugës "Bexhet Hyti" në Z.K 2654""*. (planimetri bashkëlidhur).
2. Miratimin e burimit të financimit për shpronësimin e pasurive të prekura nga projekti i lartpërmendur, i cili do të mbulohet nga buxheti i Bashkisë Elbasan për vitin 2024.
3. Për zbatimin e këtij vendimi dhe vazhdimësinë e proçedurës së mëtejshme ngarkohet Komisioni i Shpronësimit, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikim-Zhvillimit Urban dhe Shërbimeve Infrastrukturore
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI

Lutfi Lala

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA ELBASAN

SEKRETARI

Elvi Çuni

Konceptoi: G. Kerri *E. Mihali*
Drejtoria P.P.: A. Braneshi *A. Pisha*
Drejtoria F.B.: *A. Merkja*
Drejtoria P: *M. Avllazagaj*
Drejtoria J. I: *A. Hoxha*
Zv/Kryetar: *A. Bylykbashi*

Miratuar me _____ vota

Vota Pro _____

Vota kundër _____

Vota Abstenim_____

Zbardhur më datë_____/_____/2024

4953/2.
30.10.2024.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI I ZHVILLIMIT URBAN

Nr. 1192/1 prot.

Elbasan, më 30/10.2024

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të Ligjit Nr.107/2016 dt.27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", i ndryshuar, pasi u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj Nr.116 datë 23.10.2024 "Për miratimin në parim të fillimit të procedurës për shpronësimin e pasurive pronë private, për realizimin e projektit me interes publik: "Ndërtim i rrugës "Bexhet Hyti", në Z.K. 2654", nga Bashkia Elbasan dhe burimin e financimit të këtij shpronësimi", konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

Ali MYSLIU

1193

24.10.2024

REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4970/1 **Prot.** **Datë** 24 **.10. 2024**

VENDIM

NR. 117 **DATE** 23 **. 10. 2024**

MBI

"Transferim fonde në buxhetin e vitit 2024 dhe periudhën afatmesme 2025-2027",

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës 23 .10.2024, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Bashkia Elbasan mbi **"Transferim fonde për investime në buxhetin e vitit 2024, dhe periudhën afatmesme 2025-2027"**, bazuar në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqiperisë", i ndryshuar, ligjin nr.68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", "Udhëzimin plotësues nr.1, datë 24.01.2024 të Ministrisë së Financave "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023" dhe vendimin e Këshillit Bashkiak nr.126, datë 26.12.2023, për "Miratimin e Buxhetit të Bashkisë Elbasan dhe Këshillit Bashkiak për vitin 2024, si dhe miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026", i ndryshuar,

VENDOSI

1. Transferimin e fondeve në buxhetin e vitit 2024 dhe periudhën afatmesme 2025-2027, grant dhe të ardhura, njësia shpenzuese Bashkia dhe insitucionet vartëse, për financimin e objekteve për investime dhe shpenzimeve, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Buxhetit, Drejtoria e Prokurimeve dhe institucionet vartëse.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.

SEKRETAR
Elvi Çuni

KRYETAR
Lutfi Lala

P/Sekt.Buxhetit : M.Beluli
Dr.Buxh.Fin. : A.Merkja
Dr.Juridike: A.Hoxha

PAKSIME :

ne leke

burimi financimit 2024

Progr.	Funksioni	Produkti	Artikulli	Nr.	Emertimi objektit	Institucioni	gjithsej	2024	2025	2026	bashkefin.	rimb.(kap.4)	grant	te ardhura
AA109	01110	V111AAD	231	1	Mobilimi i Salles se keshillit, salles multifunksionale dhe te sherbimeve ndaj qytetareve (preventivi, 35,800,000 , me tre vite financim ,2024-2026 , viti 2024=11,050,000, viti 2025=20,000,000,viti 2026=4,750,000 lek)	***Bashkia***	35,800,000	11,050,000	20,000,000	4,750,000				11,050,000
AC109	04520	V452AAC	231	2	Rivitalizimi urban i shesheve publike te pallateve,588 etj. ne lagjen "5 Maji" (preventivi total=54,926,620, vlera e objektit =54,220,364, me dy vite financim, 2024-2025, financim i vitit 2024= 13,117,519, viti 2025=41,102,845 leke)	***ASHPU***	54,220,364	13,117,519	41,102,845				13,117,519	
					Supervizim		614,136	614,136					614,136	
					Kolaudim		92,120		92,120					
AG109	09120	V912AAK	231	3	Rikonstruksion i shkolles 9 vjecare "Fadil Gurmani" (vlera e objektit = 47,582,513 me tre vite financim 2024-2026, viti 2024=8,741,805, viti 2025=28,840,708, viti 2026=10,000,000 leke)	***Bashkia***	47,582,513	8,741,805	28,840,708	10,000,000				8,741,805
					Supervizim		586,604	586,604						586,604
					Kolaudim		87,991		87,991					
AF109	08220	V822AAC	231	4	Restaurimi i shtepise muze "Aleksander Xhuvani"	***AKT***	10,654,473	10,654,473						10,654,473
					Supervizim		95,970	95,970						95,970
					Kolaudim		19,194	19,194						19,194
AC109	04520	V452AAC	231	5	Rivitalizim urban i rrotondës tek kryqëzimi "Luleve", rrotondës "1 Maji", rrotondës "Postës"	***ASHPU***	15,506,516	15,506,516						15,506,516
					Supervizim		307,667	307,667						307,667
					Kolaudim		46,100	46,100						46,100
AC109	04520	V452AAC	231	6	Vendosje Semaforesh	***ASHPU***	4,500,000	4,500,000						4,500,000
AE109	06440	A644AAB	231	7	Blerje makine autovinç me kosh (teprice prokurimi)	***ASHPU***	889,669	889,669						889,669
AA109	01710	V171AAB	166	8	Kredia principal (teprice fondi, kredia e pa disbursuar)	***Bashkia***	3,000,000	3,000,000					2,000,000	1,000,000
AA109	01710	V171AAB	651	9	Kredia interesa (teprice fondi, kredia e pa disbursuar)	***Bashkia***	4,000,000	4,000,000						4,000,000
AI109	04910	V491AAA	609	10	Fondi rezerve	***Bashkia***	10,000,000	10,000,000						10,000,000
AH109	10430	V043AAF	231	11	Pagese TVSh, projekti: "Integrimi i Romëve dhe Egjyptianëve, nëpërmjet Edukimit dhe Punësimit", bashkef. me OSFA (gjithsej TVSH = 2088 euro, ndare 624 euro investim + 1464 euro shpenzim)	***Bashkia***	65,000	65,000						65,000
AH109	10430	V043AAF	602	12	Pagese TVSh, projekti: "Integrimi i Romëve dhe Egjyptianëve, nëpërmjet Edukimit dhe Punësimit", bashkef. me OSFA (gjithsej TVSH = 2088 euro, ndare 624 euro investim + 1464 euro shpenzim)	***Bashkia***	152,000	152,000						152,000
					Totali :		**188,220,317**	**83,346,653**	**90,123,664**	**14,750,000**	**0**	**0**	**15,731,655**	**67,614,998**

SHTESA:

ne leke

burimi financimit 2024

Progr.	Funksioni	Produkti	Artikulli		Emertimi objektit	Institucioni	gjithsej	2024	2025	2026	bashkef.	rimb.(kap.4)	grant	te ardhura
AA109	01110	V111AAD	231	1	Mobilimi i Salles se keshillit, salles multifunksionale dhe te sherbimeve ndaj qytetareve (preventivi, 12,834,821, me dy vite financim, 2024-2025, viti 2024=8,250,000, viti 2025=4,584,821 lekë)	***Bashkia***	12,834,821	8,250,000	4,584,821					8,250,000

REPUBLIKA E SHQIPËRISË- BASHKIA

AA109	01110		231	2	Furnizim vendosje sistemet audio/video dhe elektronike për sallen e Këshillit Bashkiak (gjithsej 13,053,975 lekë, me dy vite financim 2024-2025, viti 2024=3,000,000 lekë, viti 2025= 10,053,975 lekë)	***Bashkia***	13,053,975	3,000,000	10,053,975					3,000,000
AC109	04520	V452AAC	231	3	Rivitalizimi urban i shesheve publike te pallateve,588 etj. ne lagjen "5 Maji" (preventivi total=66,335,717, vlera e objektit = 65.539.426, me dy vite financim, 2024-2025, viti 2024= 25,000,000, viti 2025=40,539,426 leke)	**ASHPU**	65,539,426	25,000,000	40,539,426				13,117,510	11,882,490
					Supervizim		710,974	710,974					614,136	96,838
					Kolaudim		85,317		85,317					
AG109	09120	V912AAK	231	4	Rikonstruksion i shkolles 9 vjecare "Fadil Gurmani" (preventivi total =82,905,514,vlera e objektit = 82,018,938 me tre vite financim 2024-2026, viti 2024=20,505,000, viti 2025=31,513,938, viti 2026=30,000,000 leke)	***Bashkia***	82,018,938	20,505,000	46,513,938	15,000,000				20,505,000
					Supervizim " "		771,117	771,117						771,117
					Kolaudim		115,459		115,459					
AC109	04520	V452AAC	231	5	Rivitalizim urban i rrotondës tek kryqëzimi "Luleve", rrotondës "1 Maji", rrotondës "Postës" dhe rrotondës tek "Bashkia" (financ.2024-2025)	***ASHPU***	25,262,999	17,262,999	8,000,000					17,262,999
					Supervizim " "		329,005	329,005						329,005
					Kolaudim		49,351		49,351					
AH109	10430		231	6	Rikonstruksion i cerdhes nr.2 ne qytetin e Elbasanit (ne bashkefinancim me Raiffeisen INVEST Sh.A) (financ.2024-2025)	***Q.Ek.Arsimit***	15,436,423		12,376,423		3,060,000			
					Supervizim		197,558	197,558						197,558
					Kolaudim		23,707		23,707					
AE109	06440	A644AAC	602	7	Shpenzime ndiçim rrugor (energji elektrike)	***ASHPR***	3,000,000	3,000,000					1,783,000	1,217,000
AF109	08130	V813AAB	602	8	Shpenzime aktivitet sportiv	***Sport Klubi***	300,000	300,000						300,000
AE109	06260	V626AAH	602	9	Shpenzime dekori "Blerje markush dekorativ me vargje"	***ASHPU***	1,700,000	1,700,000						1,700,000
AB109	03140	V314AAB	602	10	Blerje veshje Policia Bashkiake	***Bashkia***	1,803,000	1,803,000						1,803,000
AH109	10430	V043AAF	231	11	Pagese TVSh, projekti: "Integrimi i Romëve dhe Egjyptianëve, nëpërmjet Edukimit dhe Punësimit", bashkef. me OSFA (gjithsej TVSH = 2088 euro, ndare 624 euro investim + 1464 euro shpenzim)	***Bashkia***	217,000	217,000				217,000		
AH109	10430	V043AAF	602	12	Marrje me qira ambiente, "Qendra Ditore" për të moshuarit (5 qendra x 30,000 leke/muaj)	***Bashkia***	300,000	300,000						300,000
					Totali :		**223,749,070**	**83,346,653**	**122,342,417**	**15,000,000**	**3,060,000**	**217,000**	**15,514,646**	**67,615,007**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

Nr. 11931/1 **Prot** **Elbasan, më** 25.10.**2024**

Lënda: Konfirmim akti.

KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.117, datë 23.10.2024 "Transferim fonde në buxhetin e vitit 2024 dhe periudhën afatmesme 2025-2027", konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI
Ali MYSLIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

1134
24.12.2024

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr .4969/1 prot. **Elbasan më 24.10.2024**

VENDIM

Nr. 118 Datë: 23.10.2024

"Miratim për marrje me qira dhe rinovim kontratash të mjediseve për t'u përdorur për shkolla dhe kopshte në disa Njësi Administrative të Bashkisë Elbasan"

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës____.10.2024, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Arsimit dhe Rinisë *"Miratim për marrje me qira të mjediseve për t'u përdorur për shkolla/kopshte për disa Njësi Administrative të Bashkisë Elbasan"* bazuar në ligjin nr.139/2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"*, në ligjin nr.115/2014 *"Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë"*,

V E N D O S I :

1. Të miratojë marrjen me qira të mjediseve për t'u përdorur për shkolla/kopshte si paraqiten në vijim:

Nr	Njesia Administrative	Subjekti qiramarrës	Qellimi qiramarrjes	Vendndodhja	Klasa nr	Sipërfaqja m²	Vlera kontrates Lekë/muaj	Subjekti qiradhenes	Rinovim kontrate / Kontrate e re
1	Gracen	Shkolla Gjorme	shkolle	Gjorme	1 (nje)	50 m²	5000	Ndricim Dokoli	Rinovim kontrate
2	Gracen	Shkolla Gjorme	shkolle	Terbac	2 (dy)	40 m²	4000	Resmi Stafa	Kontrate e re
3	Gracen	Shkolla Gjorme	kopsht	Terbac	1 (nje)	20 m²	2000	Resmi Stafa	Kontrate e re
4	Tregan	Shkolla Shilbater	kopsht	Cikallesh	1 (nje)	50 m²	5200	Ferdie Tashi	Rinovim kontrate
5	Paper	Kopshti Paper	kopsht	Mallkas	1 (nje)	87 m²	9000	Mariglen Ballhysa	Rinovim kontrate
6	Labinot Fushe	Shkolla Sulejman Rranci	kopsht	Mengel	1 (nje)	45 m²	6000	Xhevit Shabani	Rinovim kontrate
7	Elbasan	Kopshti nr 4	kopsht	Rajoni nr 6	1 (nje)	70 m²	11700	Denis Dyrmishi	Rinovim kontrate

2. Afati i kontratave është 01.09.2024 – 31.08.2025

3. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Arsimit dhe Rinisë, Drejtoria e Buxhetit dhe Financave dhe Qendra Ekonomike e Arsimit.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
Elvi Çuni

KRYETARI
Lutfi Lala

Drejtoria e DAR *J.Doci*
Drejtoria e DPKSAR *D.Rroseni*
Drejtoria e B.F *A. Merkja*
Drejtoria Juridike *A.Hoxha*
Zv/Kryetari *A.Shehu*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA ELBASAN

4969/2.
29.10.2024.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI JURIDIK

Nr. 1184/1 **Prot.** **Elbasan më** 28.10.2024

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", pas verifikimit të ligjshmërisë së aktit tuaj nr.118 datë 23.10.2024 "Miratim për marrje me qira dhe rinovim kontratash të mjediseve për tu përdorur për shkolla dhe kopshte në disa Njësi Administrative të Bashkisë Elbasan", konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

PREFEKTI

Ali Mysliu

Lgj "Brigada 17 Sulmuese", Rruga "Qemal Stafa", Tel 054 252138, ëëë.prefekti.elbasan.gov.al , email: prefekti.elbasan@mb.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

DREJTORIA E INTEGRIMIT EUROPIAN PROJEKTEVE DHE DONATOREVE

Nr 4974/1 prot

Elbasan më 24. 10. 2024

KËSHILLIT BASHKIAK

ELBASAN

VENDIM

Nr. 119, datë 23/10/2024

PËR

Mbi miratimin në parim të marrëveshjes së projektit: "Administratat publike përballen me transformimin dixhital si komunitet në zonën e Adrionit", programi: IPA Adrion00131.

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës 23/10/2024, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"

VENDOSI

1. Mbi miratimin në parim të marrëveshjes së projektit: "Administratat publike përballen me transformimin dixhital si komunitet në zonën e Adrionit", programi: IPA Adrion00131.
2. Ngarkohen për zbatim drejtoritë e Bashkisë Elbasan: Buxhet-Finances, Drejtoria e Integrimit Evropian Projekteve Strategjike Inovacionit, Drejtoria e Teknologjisë Informacionit dhe Medias dhe Drejtoria Juridike.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas miratimit në Këshillin Bashkiak.

Sekretari i Keshillit Bashkiak

Elvi Çuni

Kryetar i Keshillit Bashkiak

Lutfi LALA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN

4974/2
29.10.2024

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI JURIDIK

Nr. 1195/1 **Prot.** **Elbasan më** 29.10.**2024**

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", pas verifikimit të ligjshmërisë së aktit tuaj nr.119 datë 23.10.2024 "Mbi miratimin në parim të marrëveshjes së projektit: Administratat publike përballen me transformimin dixhital si komunitet në zonën e Adrionit, programi: IPA Adrion00131", konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI

Ali Mysliu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

Lgj "Brigada 17 Sulmuese", Rruga "Qemal Stafa", Tel 054 252138, ëëë.prefekti.elbasan.gov.al , email: prefekti.elbasan@mb.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
Këshilli Bashkiak

Nr. 5023/1 **Prot.**

Elbasan, më 24 . 10 . **2024**

Vendim

Nr 120 **Datë** 23 / 10 /**2024**

Mbi miratimin e marrëveshjes së mirëkuptimit midis Bashkisë NDI dhe SH.A.V

Këshilli Bashkiak, në mbledhejn e tij të datës 23 /10 /2024, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga administrate e Bashkisë, Drejtoria e Koordinimit e Monitorimit, mbi marrëveshjen e mirëkuptimit midis Bashkisë, Institutit Demokratik Amerikan dhe Shoqatës për Autonomi Vendore, bazuar në ligjin 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore" nenet 8,9, 15, 16, 54 të tij,

Vendosi

1- Të miratojë marrëveshjen e mirëkuptimit midis Bashkisë, Institutit Demokratik Amerikan dhe Shoqatës për Autonomi Vendore, sipas tekstit bashkangjitur

2- Ngarkohen Kryetari dhe administrata e Bashkisë me zbatimin e këtij vendimi

3- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Konceptoi:	*Koordinatore*	*L.Haxhiymeri*
Pranoi:	*Drejtori K.M.*	*T.Sinanaj*
Miratoi:	*Drejt.Pergj.*	*S.Mehmeti*
Pranoi:	*Drejt Juridike*	*A.Hoxha*

Sekretari

Elvi ÇUNI

Kryetari

Lutfi LALA

Adresa: *Bashkia Elbasan, Rr. "Q. Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al ëeb:ëëë.elbasani.gov.al*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA ELBASAN	INSTITUTI DEMOKRATIK AMERIKAN	SHOQATA PËR AUTONOMINE VENDORE
Nr 457 prot.	Nr._____ prot	Nr._____ prot.
Elbasan, më 06.09.2024	Tiranë, më__.__.___	Tiranë, më__.__.___

MARRËVESHJE MIRËKUPTIMI
MIDIS
BASHKISË ELBASAN,

Institutit Demokratik Amerikan
(më poshtë referuar NDI)

DHE

Shoqatës për Autonomi Vendore
(më poshtë referuar SHAV)

"Për promovimin e qeverisjes së hapur, transparencës, dhe përfshirjes qytetare në proçeset e vendimmarrjes publike në Bashkinë Elbasan, në përputhje me parimet dhe angazhimet e OGP"

Kjo Marrëveshje Mirëkuptimi lidhur ndëmjet Bashkisë Elbasan, e përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë, z. Gledian LLATJA, dhe Institutit Demokratik Amerikan (NDI) , përfaqësuar nga Z.Ana Kovacevic Kadovic dhe Shoqatës për Autonomi Vendore (SHAV) me përfaqësues Z. Adelina Farrici.

Neni 1: Qëllimi i Marrëveshjes së Mirëkuptimit

Qëllimi i kësaj Marrëveshje Mirëkuptimi është të krijojë një kornizë për bashkëpunim dhe mbështetje ndaj Bashkisë së Elbasanit në kontekstin e nismës lokale të Partneritetit për Qeverisje të Hapur (OGP), anëtare e së cilës Bashkia është që nga viti 2020.

Neni 2: Objektivat

Objektivat e këtij bashkëpunimi janë:

a) të forcojë dhe përmirësojë transparencën, llogaridhënien dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në qeverisjen vendore në Bashkinë e Elbasanit;
b) të krijojë mekanizma të qartë për përfshirjen e qytetarëve në proceset vendimmarrëse, përmes konsultimeve publike dhe platformave dixhitale.
c) të mbështesë zbatimin e angazhimeve të OGP-së Lokale përmes asistencës teknike, rritjes së kapaciteteve dhe nismave bashkëpunuese; dhe
d) të përmirësojë cilësinë e shërbimeve publike, duke krijuar një mjedis më të hapur dhe më të aksesueshëm për qytetarët
e) të bashkëpunojë me SHAV-in si një promovuese e transparencës, përfshirjes në vendimmarrjen në nivel lokal dhe shërbimeve cilësore me fokus te qytetarët.

Neni 3: Fusha e Veprimit

Si pjesë e programit global të NDI-së "Qeverisje e hapur: Mekanizmat nxitës në nivel lokal për planifikim, inovacion dhe zhvillim (OG-LAPIS)", NDI në Shqipëri mbështet përpjekjet e Bashkisë Elbasan drejt qeverisjes efektive vendore, përmes nxitjes dhe lehtësimit të procesit të bashkëkrijimit të angazhimeve të OGP-së lokale nga autoritetet vendore, qytetarët dhe organizatat e shoqërisë civile për një qeverisje më transparente, gjithëpërfshirëse dhe llogaridhënëse.

Procesi i bashkëkrijimit përfshin identifikimin e individëve kryesorë në bashki përgjegjës për drejtimin e procesit, përcaktimin e marrëveshjes institucionale që e mbështesin atë (grupi i punës). Po aq i rëndësishëm është edhe identifikimi, përfshirja dhe bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile dhe qytetarët aktivë si partnerë të barabartë, në Elbasan për të bashkëkrijuar angazhimet që i përgjigjen interesave dhe prioriteteve të qytetarëve. Bazuar te angazhimet, do të zhvillohet një plan veprimi i detajuar (sipas modelit të OGP-së, përfshirë afatin kohor, palën përgjegjëse dhe buxhetin) për zbatimin e tyre.

Një grup pune i përbërë nga përfaqësues të bashkisë dhe shoqërisë civile do të përcaktojë një qëllim afatgjatë të bashkëpunimit, të përshtatur me parimet e OGP-së, duke siguruar që një vizion strategjik dhe plan veprimi me angazhime konkrete të zhvillohen dhe të dorëzohen te OGP para dhjetorit 2024.

SHAV-i do të ketë një rol lehtësues dhe monitorues, duke siguruar zbatimin efektiv të angazhimeve përmes pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse të të gjithë aktorëve.

Instituti, në bashkëpunim me SHAV-in, do të ofrojë asistencë teknike për të rritur kapacitetin e Grupit të Punës së Bashkisë Elbasan në angazhimin e publikut, hartimin e angazhimeve dhe bashkëkrijimin e planit të veprimit. Instituti do të ofrojë asistencë teknike dhe koordinim ad hoc gjatë zbatimit, si konsultime të rregullta, seanca trajnimi dhe workshop-e për të rritur aftësitë dhe kapacitetet lokale dhe për të nxitur një kuadër qeverisjeje transparente dhe të llogaridhënëse në Elbasan. Përveç kësaj, Instituti do të ofrojë përvojën e tij globale me nismat e reformës së qeverisjes së hapur dhe rrjetet e tij të partnerëve brenda dhe jashtë vendit për të ndarë shembuj pozitiv të angazhimeve të reflektuara në planet e veprimit.

Neni 3: Detyrimet e Bashkisë Elbasan

1. Të identifikojë dhe emërojë individët kryesorë brenda bashkisë (Grupi i Punës i Bashkisë Elbasan) për të udhëhequr zbatimin e nismës lokale të OGP-së dhe të përcaktojë marrëveshjen institucionale më të përshtatshme për të realizuar këtë proces.

2. Të zbatojë një proces bashkëkrijimi në përputhje me udhëzimet e OGP-së për të hartuar angazhimet, duke përfshirë angazhimin e publikut dhe organizatave të shoqërisë civile në mbështetje dhe monitorim të procesit.

3. Të zhvillojë dhe përcaktojë objektiva afatgjata që janë në përputhje me parimet e OGP-së, të krijojë një vizion strategjik dhe plan veprimi me angazhime konkrete sipas modelit të OGP-së dhe të sigurojë një buxhet të dedikuar për mbështetjen e zbatimit të këtyre përpjekjeve.

4. Të sigurojë dorëzimin e vizionit strategjik dhe planit të veprimit në OGP brenda dhjetorit 2024 dhe t'i përmbahet udhëzimeve dhe detyrimeve të përshkruara në doracakun e OGP-së.

Neni 4: Detyrimet e NDI

1. Të organizojë dhe të mbajë seanca trajnimi, workshop-e dhe shkëmbime eksperiencash për zyrtarët dhe aktorët e shoqërisë civile të Bashkisë së Elbasanit.

2. Të mbështesë një proces bashkëkrijimi gjithëpërfshirës me autoritetet vendore, shoqërinë civile dhe qytetarët për zhvillimin e vizionit strategjik dhe planit të veprimit që do të dorëzohet në OGP.

3. Të mbështesë krijimin e mekanizmave të monitorimit dhe vlerësimit për nismat e OGP-së në bashkëpunim me SHAV-in.

4. Sipas nevojës, të mbulojë tarifat e trajnerëve dhe lehtësuesve përkatës, kostot e transportit dhe/ose akomodimit për pjesëmarrësit që udhëtojnë drejt ose jashtë Elbasanit, përveç kostove të tjera të takimeve gjatë seancave të trajnimit.

Neni 5: Detyrimet e SHAV

1. Të shërbejë si organ monitorues dhe mbështetës për nismën lokale të OGP-së në Elbasan.

2. Të sigurojë përfshirjen e aktorëve të ndryshëm në procesin e bashkëkrijimit.

3. Të monitorojë ecurinë e angazhimeve të OGP-së dhe të ofrojë udhëzime dhe komente për Bashkinë Elbasan dhe NDI-në.

4. Të vlerësojë nismën e bashkisë Elbasan dhe të promovojë nisma të ngjashme në bashki të tjera.

Neni 6: Rezultatet e pritshme

Bashkia Elbasan, me mbështetjen dhe ndihmën e NDI-së dhe SHAV-it, bie dakord të punojë drejt përmbushjes së rezultateve të mëposhtme deri më 1 dhjetor 2024:

1. Zhvillimi i një plani për bashkëkrijimin e angazhimeve në kuadër të OGP-së, duke përshkruar përgjegjësitë dhe afatet për çdo hap.

2. Zbatimi i një procesi bashkëkrijimi që përfshin angazhimin e publikut dhe shoqërisë civile.

3. Hartimi i dy dokumenteve kryesore që përfshijnë vizionin strategjik dhe planin e veprimit me angazhime, që do të dorëzohen në OGP deri më 1 dhjetor 2024.

Neni 7: Shkëmbimi i informacionit dhe dokumenteve

Për të ruajtur natyrën konfidenciale ose të kufizuar të disa informacioneve dhe dokumenteve, duke iu nënshtruar rregullimeve apo kufizimeve të nevojshme, Palët do të angazhohen të shkëmbejnë informacione mbi çështje me interes të përbashkët dhe në veçanti:

a) Secila Palë angazhohet të informojë rregullisht palën tjetër për ecurinë drejt rezultateve të pritura dhe për fushat prioritare të bashkëpunimit siç janë identifikuar nga organizatat përkatëse;
b) Grupi i Punës i Bashkisë Elbasan do të shqyrtojë çdo propozim të bërë nga NDI në lidhje me zhvillimin dhe zbatimin e planit të veprimit të lidhur me OGP dhe aktivitetet/takimet e përcaktuara në Marrëveshjen e Mirëkuptimit.
c) NDI do të shqyrtojë dhe ofrojë komente/sugjerime për Grupin e Punës së Bashkisë Elbasan që lidhen me aktivitetet/takimet e planit të veprimit të OGP-së të përcaktuara në Marrëveshjein e Mirëkuptimit.

Neni 7: Statusi Ligjor i Dokumentit:

Kjo Marrëveshje Mirëkuptimi nuk është ligjërisht detyruese për asnjërën nga palët. NË DËSHMI TË KËSAJ, të nënshkruarit, të autorizuar për këtë qëllim nga organizatat përkatëse, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje Mirëkuptimi.

Neni 8: Mbajtja e komunikimit

Të gjitha komunikimet në lidhje me zbatimin e Marrëveshjes adresohen si më poshtë:

Për Bashkinë e Elbasanit:

Emër/Mbiemër Armand Shehu
Pozicioni: Zv/Kryetar
Tel: 0672121877
E-mail: armand.shehu@elbasani.gov.al

Emër/Mbiemër Lorena Haxhiymeri
Pozicioni: Koordinatore Performance
Tel: 0696571871
E-mail: lorena.haxhiymeri@elbasani.gov.al

Për NDI
Emër/Mbiemër: Armela Prevazi
Pozicioni: Menaxhere Programi
Tel: +355 69 20 30 207
E-mail: aprevazi@ndi.org

Për SHAV
Emër/Mbiemër: Elisa Nikaj
Pozicioni: Asistente e Menaxherit te Programit
Tel: +355 69 46 10 587
E-mail: elisanikaj88@gmail.com

Neni 9: Ndryshimet, përfundimet dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo ndryshim i kësaj Marrëveshje do të kryhet me shkrim me mirëkuptim të përbashkët mes palëve. Mosmarrëveshjet që mund të lindin nga zbatimi i kontratës do të zgjidhen me mirëkuptim midis palëve.

Neni 10: Hyrja në fuqi

Ky Marrëveshje Mirëkuptimi do të hyjë në fuqi pas nënshkrimit nga të gjitha palët e përfshira për kohëzgjatjen e jetëgjatësisë së programit, që nga periudha e shkrimit dhe aplikimit të projektit, deri në zbatimin e plotë të tij.

PËR
BASHKINË ELBASAN
KRYETARI I BASHKISË

Gledian LLAJA

Datë: 26.09.2024

PËR
NDI
DREJTORESHË E NDI
SHQIPËRINË

Ana Kovacevic KADOVIC

Datë: 26.09.2024

PËR
SHAV
DREJTOR EKZEKUTIV SHAV

Adelina FARRICI

Datë: 26.09.2024

5023/2.
29.10.2024.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI JURIDIK

Nr. 1188/1 **Prot.** **Elbasan më** 29/10 **.2024**

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", pas verifikimit të ligjshmërisë së aktit tuaj nr.120 datë 23.10.2024 "Mbi miratimin e marrëveshjes së mirëkuptimit midis Bashkisë NDI dhe SH.A.V", konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI

Ali Mysliu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË-N.V.A. PREFEKTI I QARKUT ELBASAN